# DËSHMI ARKIVI

**A-398558**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kakavija, pika kryesore e kalimit të klandestinëve |
| ADRESA | `https://www.balkanweb.com/kakavija-pika-kryesore-e-kalimit-te-klandestineve-nga-vendet-e-treta-1300-vete-ne-6-muaj/` |
| BURIMI | balkanweb.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 00:17:10 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 13 qershor 2018, 14:54:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 13 qershor 2018, 14:53:00 UTC → 13 qershor 2018, 14:55:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `9b5ea41d970404e47462fc1ec397ce690689b8b38d7926c68609cb9f37ff8a54` |
| TEKSTI | `11e76adc140345ab0f73a43269e9d9439eb8d95b7e52f884d07f119d51622d26` |
| PAMJA | `3bee179de5edb99abf5fb59cc350fafe8b8b634265cc1c59f898ac8795babbc6` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4b0af563caee0cdc9a0a7940970bc00b8ca50a6046a859d497fb45bb5165dc7a` |
| E MËPARSHMJA | `42811e7e747101f239ae4fd85e323b1791bb4a817d976df91879dc85cabc2b6a` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4b0af563caee0cdc9a0a7940970bc00b8ca50a6046a859d497fb45bb5165dc7a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

balkanweb back button

- Balkanweb TV
- Foto Galeri
- Emisione
- Moti
- Sondazh
- Shtypi
- Dossier
- Shëndeti
- Gatimi
- Horoskopi
- News24
- Kontakt

- logo balkanweb e madhe
-
-
-

- Fillimi
- Minutë pas minute
- Shqipëria
- Politikë
- Kronikë
- Ekonomi
- Kosova
- Rajoni
- Sport
- Bota
- Kulturë
- Metropol
- Analiza
- Teknologji
- Shëndeti
- Horoskopi
- Emisione

logo balkanweb e madhe
logo gazeta shqiptare
Kerko ketu
Download on Apple Store Get it on Google Play

- Fillimi
- Minutë pas minute
- Shqipëria
  - -Kronikë
  - -Politikë
  - Aktualitet
  - -Ekonomi
  - -Sociale
  - -Kulturë
- Politikë
- Kronikë
- Ekonomi
- Kosova
- Rajoni
  - -Greqi
  - -Maqedoni
  - -Serbi
- Sport
  - -Bota
  - -Shqipëri
  - EURO 2024
- Bota
  - USA 2024
  - Lufta në Ukrainë
- Kulturë
  - -Art
  - -Libra
  - -Filma
  - -Muzikë
- Metropol
  - -Kuriozitete
  - -Life-Style
  - -Personazhe
  - -Show Bizz
- Analiza
- Teknologji
  - -Auto-Moto
  - -Pc-Mobile
  - -Shkence
- Shëndeti
- Horoskopi
- Emisione

Minute pas minute

- Dashuria, paratë, karriera, njihuni me horoskopin për ditën e sotme, 10 Shtator 2026
- EKSKLUZIVE! “Ti merru me qeverinë”, Ahmetaj zbardh bisedat e Ron Yeffet: Procesin duhet ta bëjmë në mënyrë të heshtur! Mediat ...
- Mbyllet tubimi i 102, thirrjet e protestuesve: Nesër më shumë
- Arben Ahmetaj: Thonë se Rama nuk merr para, por edhe El Chapon nuk e kapën duke shpërndarë drogë. Nxjerrja e News24 nga godina...
- VIDEO/ PSG e nis frikshëm Championsin, Liverpool fiton ndaj Atleticos, një gol vendos Napoli-Arsenal

- Fillimi
- >
- Shqipëria

# Kakavija, pika kryesore e kalimit të klandestinëve

13 Qershor, 2018 16:54

**Madhësia e tekstit:**

Balkanweb app [Download on Apple Store][Get it on Google Play]

NGA *BRIKENA METAJ*

**GJIROKASTER–** Muajt e parë të 2018-s kanë shënuar një shifër rekord të klandestinëve nga vendet e Lindjes që hyjnë në mënyrë të paligjshme në Shqipëri. Në Gjirokastër, vetëm për gjashtë muajt e parë të viti 2018, janë kapur nga Policia Kufitare e Kakavijës në territorin shqiptar, rreth 1300 shtetas të huaj të hyrë në mënyrë të paligjshme.

Pothuajse 80% e tyre kanë kërkuar azil, duke u strehuar në Qendrën Kombëtare Pritëse për azilkërkuesit në Tiranë, ndërsa pjesa tjetër janë rikthyer në Greqi. Shifra e kërkesës për azil duket se ka ardhur në rritje gjatë muajve Prill dhe Maj me mbi 200 persona azilkërkues. Një numër i vogël i shtetasve të paligjshëm janë gra e fëmijë, ndërsa mosha mesatare e tyre varion nga 18 – 40 vjeç.

Shifra rekord e imigrantëve të paligjshëm është shënuar në datat 3 dhe 4 mars 2018 kur nga uniformat blu janë ndaluar 49 shtetas të huaj, 31 prej të cilëve janë dërguar në Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit në Babrru, ndërsa pjesa tjetër e tyre u procedua me urdhër ekzekutimi vullnetar.

Ajo që bie në sy është gjeografia e gjerë e shtetasve të paligjshëm që hyjnë në kufirin shqiptar, duke përfshirë jo vetëm vende si Siria, por edhe Libia, Maroku, Algjeria, Afganistani, Iraku, Tunizia apo Pakistani.

Sipas njoftimeve të policisë, Kakavija duket se është pika kryesore e kalimit të imigrantëve nga vendet e treta, që vijnë nga Janina me autobus apo edhe me këmbë duke ecur për ditë të tëra. Ata përshkojnë Luginën e Drinos duke ecur kryesisht përgjatë shtratit të lumit, nëpër fshatrat e Dropullit apo edhe më tej.

Imigrantët e paligjshëm ndjekin të njëjtën praktikë si ajo e fillimit të ardhjes masive të tyre. Ata vijnë nga vendet e origjinës në Turqi, ku u duhet të paguajnë nga 350 – 600 euro secili për të kaluar në Greqi. Akomodimi i tyre disaditor bëhet në Athinë, ndërsa më pas përshkojnë itinerarin Athinë – Janinë – Kakavijë – Gjirokastër në drejtim të Shkodrës, me synim Malin e Zi dhe më pas kalimin në vendet e BE. Ky aks njihet nga këta imigrantë si rrugë kalimi e sigurt.
refugjatet54
Së fundmi, Mali i Zi deklaroi mundësinë e ndërtimit të një muri me tela në kufirin me Shqipërinë, me qëllim parandalimin e kalimit të emigrantëve ilegalë.

Me gjithë masat e marra nga policia kufitare, imigrantët dhe refugjatët arrijnë të depërtojnë të ndihmuar edhe nga trafikantët. Përgjatë muajve të parë të 2018-ës Policia e Gjirokastrës ka goditur 8 raste të trafikimit të klandestinëve, me 15 autorë, nga të cilët 8 janë arrestuar, 4 të ndaluar, ndërsa 3 ndiqen në gjendje të lirë.

Ajo që duket më shqetësuese është intensifikimi i këtij fenomeni që vë në dukje një shtim të ndjeshëm të klandestinëve nga vendet e Lindjes, të cilët tentojnë të kalojnë nëpërmjet Shqipërisë në vendet e BE-së. Raportimet zyrtare flasin për ndalime të përditshme, me shifra përherë në rritje të tyre, ndërsa e vetmja masë parandaluese janë veprimet burokratike me regjistrime të dhënash të imigrantëve të paligjshëm dhe rikthimi i tyre në Greqi apo në vendet e origjinës.

Një pjesë e mirë e këtyre shtetasve kanë tentuar për më shumë se një herë të depërtojnë nëpërmjet territorit shqiptar, pikërisht për shkak të mosndëshkueshmërisë ligjore të tyre.

Në Gjirokastër ka tre qendra pritjeje për klandestinët. Qendra e Gërhotit është më e madhja prej tyre, me kapacitet 64 shtretër, qendra komunitare e bashkisë ka 15 shtretër, ndërsa qendra në Gos ka rreth 15 – 20 shtretër. Të gjitha janë qendra pritëse të përkohshme ku klandestinët strehohen deri në përfundim të kryerjes së procedurave ligjore.

**(BalkanWeb)**

© **BalkanWeb**

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

**Etiketa:**

- DOGANA E KAKAVIJES
- klandestine

### Të ngjashme

![Policia Sarande 840x440]

**Në kërkim për trafik klandestinësh, arrestohet i riu nga Pogradeci**

05 Korrik, 2023

![Vaityomqhq3vtyibay4wd2h4fa (1)]

**Rrjeti kriminal që po varfëron vendin, shqiptarët paguan mbi 43 mln euro trafikantët për të shkuar me gomone në Britani në janar-shtator 2022**

02 Shkurt, 2023

loading...

### Të Fundit nga Shqipëria

![Img 2896]

**EKSKLUZIVE! "Ti merru me qeverinë", Ahmetaj zbardh bisedat e Ron Yeffet: Procesin duhet ta bëjmë në mënyrë të heshtur! Mediat dhe lajmet… (VIDEO)**

09 Shtator, 2026

![8ba0772d 6e9a 4844 A19f 8379a19bc9f4]

**Mbyllet tubimi i 102, thirrjet e protestuesve: Nesër më shumë**

09 Shtator, 2026

![Ametaj]

**Arben Ahmetaj: Thonë se Rama nuk merr para, por edhe El Chapon nuk e kapën duke shpërndarë drogë. Nxjerrja e News24 nga godina, me urdhër të kryeministrit**

09 Shtator, 2026

![21 Dhjetori1]

**102 ditë protestë/ Nuk ndalen protestuesit, marshim kilometrik në rrugët e Tiranës**

09 Shtator, 2026

![21 Dhjetori2]

**"Dorëheqje"/ Protestuesit ulen tek Kryqëzimi tek 21 Dhjetori, bllokojnë qarkullimin e mjeteve**

09 Shtator, 2026

![Photo Output]

**Kronikat e skemave të dyshimta financiare në Shqipëri**

Redi Ametllari | 09 Shtator, 2026

### Kategoria Video

![8ba0772d 6e9a 4844 A19f 8379a19bc9f4]

**Mbyllet tubimi i 102, thirrjet e protestuesve: Nesër më shumë**

09 Shtator, 2026

![Img 0527]

**VIDEO/ PSG e nis frikshëm Championsin, Liverpool fiton ndaj Atleticos, një gol vendos Napoli-Arsenal**

09 Shtator, 2026

![21 Dhjetori1]

**102 ditë protestë/ Nuk ndalen protestuesit, marshim kilometrik në rrugët e Tiranës**

09 Shtator, 2026

![21 Dhjetori2]

**"Dorëheqje"/ Protestuesit ulen tek Kryqëzimi tek 21 Dhjetori, bllokojnë qarkullimin e mjeteve**

09 Shtator, 2026

![Vasil Shanto1]

**"Ju erdhi fundi"/ Protestuesit mbërrijnë tek Vasil Shanto, thirrje të forta kundër qeverisë: Rama në burg, Balluku në burg**

09 Shtator, 2026

![Marshii Drejtoria]

**LIVE- Vijon aksioni qytetar! Protestuesit marshojnë drejt Policisë së Tiranës, kumbojnë thirrjet: Ju erdhi fundi!**

09 Shtator, 2026

loading...

Balkanweb app Download on Apple Store Get it on Google Play

Kerko ketu

### Lajmet e fundit

- [8ba0772d 6e9a 4844 A19f 8379a19bc9f4]

  [**Mbyllet tubimi i 102, thirrjet e protestuesve: Nesër më shumë**]

  09 Shtator, 2026

  [Img 0527]

  [**VIDEO/ PSG e nis frikshëm Championsin, Liverpool fiton ndaj Atleticos, një gol vendos Napoli-Arsenal**]

  09 Shtator, 2026

  [21 Dhjetori1]

  [**102 ditë protestë/ Nuk ndalen protestuesit, marshim kilometrik në rrugët e Tiranës**]

  09 Shtator, 2026

  [21 Dhjetori2]

  [**"Dorëheqje"/ Protestuesit ulen tek Kryqëzimi tek 21 Dhjetori, bllokojnë qarkullimin e mjeteve**]

  09 Shtator, 2026

  [Vasil Shanto1]

  [**"Ju erdhi fundi"/ Protestuesit mbërrijnë tek Vasil Shanto, thirrje të forta kundër qeverisë: Rama në burg, Balluku në burg**]

  09 Shtator, 2026

  [Marshii Drejtoria]

  [**LIVE- Vijon aksioni qytetar! Protestuesit marshojnë drejt Policisë së Tiranës, kumbojnë thirrjet: Ju erdhi fundi!**]

  09 Shtator, 2026

- Emisione

**Mediat e huaja**

- New York Times
- Guardian
- WEB BBC
- WEB CNN
- REUTERS
- Washington Post
- Times Online
- Financial Times
- WEB Yahoo
- WEB MSN
- USA Today

© BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

logo Twitter logo Facebook logo Instagram logo Youtube
scroll to top
logo balkanweb

**Emisione news24**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.